



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.04.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:31 dhe mbaroi në orën 14:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Klodian Kurushi.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, i përgatitur nga komisioni i planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit.

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e datës 07.04.2023, në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës.

Për më tej, meqenëse edhe relatimet ditën e djeshme u bënë nga ana ime, po vazhdoj me relatimin e projekt-aktit përkatës.

Relacion “Mbi projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efijencës, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre, në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, po vijon me procesin për funksionimin e brendshëm të gjykatave pritëse, për të cilin është përgatitur edhe akti përkatës.

Mbi harmonizimin e aktit:

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm fillojnë funksionimin në datën 01.05.2023.

Akti i propozuar për miratim ka për qëllim ndryshimin e vendimit nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, duke ndryshuar përbërjen e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për shkak të fakti ligjor të ndodhur pas miratimit të vendimit nr. 167/2023.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.04.2023 ka miratuar me vendimin nr. 167, datë 06.04.2023, krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me përbërje sipas përcaktimeve ligjore.

Ndodhur në kushtet kur zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, z. Besnik Shehu, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në datë 06.04.2023 shkarkohet nga KPK, për funksionalitetin e Komisionit të Ristrukturimit, bëhet zëvendësimi i tij me z. {...}.

Zoti {...}, pas mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datë 07.04.2023, zgjidhet zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, njoftuar me e-mail më datë 07.04.2023.

Pra ne sot propozojmë projektvendimin, në përmbajtje të të cilit është zëvendësimi i zotit Besnik Shehu, i cili është miratuar si anëtar i Komisionit të Ristrukturimit me vendimin nr. 167, datë 06.04.2023, me zotin {...}, i cili është aktualisht zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për çfarë u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj anëtarët në votim të projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 167, datë 06.04.2023 “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, duke ndryshuar përbërjen e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, si më poshtë:

Zoti Besnik Shehu, anëtar (zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë), zëvendësohet me z. {...}, anëtar (zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë).

2. Pikat e tjera të vendimit nr. 167 nuk ndryshohen.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Me miratimin e këtij vendimi mbledhjen e deklarohet të mbyllur, duke ju uruar ditë pushimi të qeta.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor